



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:051832

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05479383

KA.nr.316/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Lab-Oil” ShPK me numër të biznesit 70623331 dhe seli në fshatin Preoc në Graçanicë, kundër të paditurit Qeveria e Kosovës, Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Inspektorati i Tregut me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 27.02.2023 në të cilën morën pjesë të gjitha palët dhe përfaqësuesit e tyre, më 1 mars 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Lab-Oil” ShPK me numër të biznesit 70623331 ndaj të paditurit Qeveria e Kosovës, Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Inspektorati i Tregut, me të cilën ka kërkuar anulimin e akti administrativ nr. ref. 19/20 i datës 24.03.2020 i shkallës së parë dhe akti administrativ ref. 19 i datës 08.04.2020 i të paditurit.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 13.05.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e aktit administrativ nr. ref. 19/20 të datës 24.03.2020 të Inspektoratit të Tregut si organ administrativ i shkallës së parë në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike dhe aktit administrativ ref. 19 i datës 08.04.2020 të Inspektoratit të Tregut

si organ administrativ i shkallës së dytë ë kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike.

2. Padiësi në padi po edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka pretenduar se gjatë inspektimit nga Inspektorati i Tregut është obliguar që në afatin prej tetë ditëve t'ia dërgoj atij certifikatën e cilësisë për mostrat e marra, të cilat i ka dërguar në mënyrë elektronike në e-mail adresën ...@rks-gov.net, të cilën inspektorati ia ka lënë. Sipas tij, pavarësisht kësaj Inspektorati i Tregut në shkallë të parë i ka shqiptuar gjobë, ndërsa Inspektorati i Tregut në shkallën e dytë ia ka refuzuar ankesën, edhe pse ankesës ia ka bashkëngjitur provën që dëshmon se e ka dorëzuar dokumentin e kërkuar.
3. I Padituri në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Padiësit dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë, ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor nuk mori fare pjesë, ndonëse ishte ftuar me rregull. Sipas tij, vendimi i shkallës së parë nuk është përcjellë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, si drejtë është aplikuar e drejta materiale dhe procedurale.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

4. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: procesverbali i të paditurës me numër serik 001642; aktvendimi ref. 19/20 i datës 24.03.2020 i Inspektoratit të Tregut; ankesa e padiësit e protokolluar me numër 1673 me datë 07.04.2020; vendimi nr. ref. 19 i datës 08.04.2020 i Inspektoratit të Tregut si shkallë e dytë; komunikimi me e-mail i datës 20.03.2020 i V.B. në drejtim të e-mailit ...@rks-gov.net; raporti i analizave në gjuhën angleze me numër të raportit 88807/00015786.1/L/20 i datë 13.02.2020; certifikata e analizës me numër 165 e datës 29.10.2019; parashtrësën nga kryeinspektori i Inspektoratit të Tregut për Avokaturën Shtetërore me numër të protokollit 7325/19 të datës 11.12.2023;
5. Në bazë këtyre provave gjykata konstaton se Inspektorati i Tregut në shkallën e parë më 12.03.2020 e kishte inspektuar lokalitetin e të Padiësit në Shirokë dhe kishte konstatuar që Padiësi nuk e posedon certifikatën e mostrave të marra, rrjedhimisht e kishte detyruar atë që brenda afatit prej tetë ditëve t'ia dorëztoj atë dokument Inspektoratit të Tregut. Në atë procesverbal nuk ishte shënuar askund adresa elektronike e inspektorit

përgjegjës ose e Inspektoratit të Tregut. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes procesverbalit nr. 001642 të datës 12.03.2020.

6. Paditësi më 20.03.2020 e kishte dërguar një letër elektronike me titullin “Testet e mostrave Lab Oil Shirokë” nga e-mail adresa valon.berisha@laboil-ks.com në e-mailin ...@rks-gov.net. Ajo letër elektronike nuk ka përmbajtje të shkruar, ndërsa në të figurojnë të jenë të bashkëngjitura dy dokumente, titulli i të cilave nuk shihet. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes komunikimi me e-mail i datës 20.03.2020 i V.B. në drejtim të e-mailit ...@rks-gov.net.
7. Më 24.03.2020 Inspektorati i Tregut në shkallën e parë e kishte nxjerrë aktvendimin ref. 19/20 të datës 24.03.2020, me të cilin i kishte shqiptuar Paditësit gjobë në shumë prej 1000€ për mos dorëzim të dokumenteve të kërkuara. Këtë fakt gjykata e konstatoi përmes aktit administrativ të sapo cekur.
8. Më 07.04.2020 Paditësi kishte ushtruar ankesë nga aktit administrativ të sapo cekur, duke pretenduar se dokumenti i kërkuar është dorëzuar me kohë përmes e-mailit. Këtë fakt gjykata e konstatoi përmes ankesës të sapo cekur.
9. Inspektorati i Tregut në shkallën e dytë përmes vendimit nr. ref. 19 të datës 08.04.2020 e ka refuzuar ankesën e Paditësit dhe e ka vërtetuar aktin administrativ të shkallës së parë. Në këtë vendim Inspektorati i Tregut si shkallë e dytë kishte arsyetuar mes tjerash se inspektorja e rastit nuk e ka pranuar asnjë e-mail nga Paditësi, ndërsa e-maili nuk e ka asnjë përmbajtje. Këtë fakt gjykata e konstatoi përmes aktit administrativ të sapo cekur.
10. Provat tjera të administruara nga gjykata nuk provuar ndonjë fakt tjerët relevant lidhur me këtë çështje, prandaj gjykata vendosi të mos lëshohet në elaborimin e hollësishëm të tyre.
11. Nga analizimi i veç e veç dhe i përbashkët i fakteve të cekura më lart, gjykata duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës siç përcakton nenit 332 para. 1 i LPK-së erdhi në përfundim se nuk është provuar se Paditësi si palë në procedurën administrative e kishte përmbushur detyrimin e tij që brenda afatit prej tetë ditëve t’i mundësoj qasje në dokumentacion Inspektoratit të Tregut si organ i shkallës së parë.
12. Në këtë drejtim gjykata rikujtoj se Paditësi e ka barrën e provës në kuptim të nenit 332 para. 2 të LKA-së, sipas të cilit “*Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk*

parasheh diç tjetër”. Prandaj, Paditësi ka qenë juridikisht i obliguar që në këtë procedurë të paraqes prova nga të cilat rrjedh se ai brenda afatit tetë ditor ia ka dorëzuar Inspektoratit të Tregut si organ administrativ i shkallës së parë dokumentin e kërkuara.

13. Për këtë gjykatë, nga letra elektronike siç është përshkruar në pikë 6 të këtij arsytimi nuk mund të provohet se Paditësi e ka përmbushur obligimin e tij për mundësim të qasjes në dokumente. Në rend të parë nga ajo letër nuk mund të kuptohet se çfarë dokumente i ishin bashkëngjitur dhe se a kanë qenë i bashkëngjitur pikërisht dokumenti i kërkuar nga Inspektorati i Tregut si organ administrativ i shkallës së parë. Përveç kësaj, në letrën elektronike nuk jepen sqarime lidhur me dokumentet e dërguara, përveç titullit të letrës elektronike, që për këtë gjykata është e pamjaftueshme që të krijohet lidhja mes dokumenteve të dërguara dhe dokumenteve të kërkuara.
14. Faktin se Paditësi përmes ankesës në procedurën administrative e kishte bashkëngjitur certifikatën e kërkuara gjykata e pati të pamundur ta trajtoj si përmbushje të detyrimit të tij, pasi në atë kohë veç se kishte kaluar afati tetë ditor për dorëzimin e atij dokument. Gjykata sqaron se, edhe pse neni 94 të LPPA-së pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të paraqesë mendime, shpjegime për faktet, rrethanat apo edhe çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me procedurën përkatëse, së bashku me provat e dokumentet përkatëse, në të cilat i mbështet ato si dhe të paraqesë propozime për zgjidhjen e çështjes, megjithatë gjeti se nuk mund të zbatohet në këtë rast, pasi dorëzimi i dokumenteve të kërkuara ka qenë i lidhur me afat, rrjedhimisht pasoja juridike e mos dorëzimit të dokumentit të kërkuar nga Inspektorati i Tregtisë ishte shkaktuar në momentin kur kishte kaluar afati tetë ditor.

III. Vlerësimi meritore i rastit

15. Gjykata pas analizimit të thënave të Paditësit dhe të Paditurit, si dhe provave në shkresat e lëndës në kuptim të nenit 8 të LPK-së erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Paditësit është e pabazuar në ligj.
16. Gjendja faktike e përshkruar më lart rregullohet me nenin 14 të Ligjit 03/L181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut (këtu e tutje LIMT), i cili në para. 2 ka përcaktuar se *“Subjekti ekonomik sipas kërkesës së inspektorit, është i detyruar që menjëherë t’i ofroi të dhënat e mundshme e të nevojshme, ndërsa për raste të shtyshme sipas vlerësimit, brenda afatit të përcaktuar nga inspektori”*, ndërsa në para. 3 të po të

njëjtit nën ka përcaktuar se “*Subjekti ekonomik i cili mbikëqyret konsiderohet që nuk i ka mundësuar inspektorit kryerjen e mbikëqyrjes nga paragrafi 1. i këtij neni nëse edhe brenda afatit të përcaktuar me procesverbalin e inspektorëve, nuk siguron qasje në produkte, dokumentacionin e kërkuar të punës dhe dokumente tjera të nevojshme për të konstatuar gjendjen faktike të mbikëqyrjes së filluar*”. Sipas këtyre dispozitave, Inspektorati Tregut ka të drejtë që t’i lejoj një subjekti ekonomik që në afatin e caktuar nga ai t’ia dorëzoj dokumentet, në të cilat ka kërkuar që të ketë qasje por që kanë munguar me rastin e inspektimit, ndërsa nëse subjekti ekonomik nuk vepron brenda afatit të caktuar nga Inspektorati i Tregut, atëherë konsiderohet se nuk i ka mundësuar qasje Inspektorati i Tregut.

17. Gjithashtu sipas nenit 33 para. 1 të LIMT-së (i ndryshuar) “*Inspektori i tregut për shkeljet e konstatuara me këtë ligj i shqipton gjobat në vijim: 1.1. me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, ndëshkohet personi juridik për shkeljet e përcaktuara në nenin 14 të ligjit bazik*”. Kjo nënkupton se, nëse personit juridik nuk i mundëson qasje Inspektoratit të Tregut sipas nenit 14 të LIMT-së, pra edhe pas mundësisë që dokumentin e kërkuar ta dorëzoj brenda afatit të caktuar, atëherë ai gjobitet në shumën e paraparë në atë paragraf.
18. Prandaj, meqenëse Paditësi nuk ia ka dorëzuar me kohë Inspektoratit të Tregtisë dokumentin e kërkuar, atëherë ky i fundit me të drejtë i ka shqiptuar gjobë me aktin administrativ të shkallës së parë, ndërsa në shkallë të dytë me të drejtë është refuzuar ankesa e Paditësit.
19. Në anën tjetër, gjykata gjen se procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullova e procedurale të procedurës administrative. Në këtë drejtim, gjykata vëren se nga Paditësi nuk ishte ndritur asnjë pretendim i kësaj natyre gjatë procedurës së konfliktit administrativ.
20. Përveç kësaj, gjykata vëren se i Padituri ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, si dhe për të gjitha pretendimet e Paditësit, që i ka paraqitur gjatë gjithë procedurës administrative. Gjukata vëren se Paditësi nuk kishte paraqitur pretendim lidhur me mungesat eventuale në arsyetimin e vendimit të goditur.
21. Gjukata gjithashtu konstaton se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsyetim.

22. Prandaj gjykata përfundimisht vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, rrjedhimisht duhet të refuzohet. Për këto arsye, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.316/2022

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.